

VENDIM
Nr. 199, datë 3.4.2024

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS DHE TË NIVELEVE TË
PAGAVE TË NËPUNËSVE TË TASK-FORCËS PËR MONITORIMIN,
INSPEKTIMIN DHE MARRJEN E MASAVE PËR MBROJTJEN DHE
PËRMIRËSIMIN E INFRASTRUKTURËS, PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE TË
NDOTURA QË SHKARKOHEN PRANË OSE NË UJËRA LARËSE NË ZONAT
BREGDETARE, OSE NË BREGUN E LIQENEVE E TË LUMENJVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strukturës së pagës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të Task-Forcës për Monitorimin, Inspektimin dhe Marrjen e Masave për Mbrojtjen dhe Përmirësimin e Infrastrukturrës për Trajtimin e Ujërave të Ndotura që Shkarkohen pranë ose në Ujëra Larëse në Zonat Bregdetare, ose në Bregun e Liqeneve e të Lumenjve, në vijim “Task-Forca”.

2. Elementet përbërëse të pagës bruto mujore të nëpunësve të “Task-Forcës”, (paga për pozicion, shtesa për vjetërsi dhe shtesa për nivelin e kualifikimit) për secilën klasë të përcaktuar në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si dhe vlerat për secilin element janë të njëjta me ato të miratuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në institucionet e administratës shtetërore.

3. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të nëpunësve të “Task-Forcës” janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Trajtimi me pagë dhe shtesa mbi pagë për nëpunësit e “Task-Forcës”, sipas këtij vendimi, do të vazhdojë sipas afateve të përcaktuara për funksionimin e saj, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 6, të aktit normativ nr. 8, datë 28.12.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave urgjente, për mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës për trajtimin e ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse”.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2024, përballohen nga fondet e miratuara në tavanet buxhetore për Ministrinë e Infrastrukturrës dhe Energjisë për këtë vit, në programin “Furnizimi me ujë dhe kanalizime” dhe fillojnë nga data e emërimit të nëpunësve në detyrë.

6. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturrës dhe Energjisë, “Task-Forca” dhe Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës-Kanalizimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1

**Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune
(natyrë të veçantë pune) të nëpunësve të “Task-Forcës”**

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës	Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) lekë
Drejtues	I-4	1	70 000
Përgjegjës sektori	III-1	1	50 000

	III-2	1	30 000
Inspektor terreni	IV-1	1 ose 2	50 000
Specialist	IV-1	1 ose 2	30 000
	IV-2	1 ose 2 ose 3	0